REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 48/17, 58/17
Datë/Datum. 06.03.2017
PRISHTINË / PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Komuna Fushë Kosovë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.48-58/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave"**, me nr. prokurimi: **6120/16/097/221**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Er-Lisi sh.p.k & Ve-Mor" sh.p.k-Pejë , OE NTSH "Kanalprofis",**		
Datë	**06.03.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, oastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave"** me nr. prokurimi: **6120/16/097/221",** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Fushë Kosovë**, dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"Er-Lisi sh.p.k & Ve-Mor" sh.p.k - Pejë** dhe OE NTSH "Kanalprofis", me seli në Fushë Kosovë, me nr.prot.**48/17,** e datës **20.02.2017.** dhe nr.prot.**58/17, të dt.28.02.2017.**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave ,** me nr. prokurimi:**6120/16/097/221** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Fushë Kosovë.**

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		01.03.2017		03.03.2017		06.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 20.02.2017 dhe dt.28.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 48/17 dhe 58/17, e parashtruar nga operatori ekonomik: "Er-Lis sh.p.k & Ve-Mor" sh.p.k-Pejë, dhe OE NTSH "Kanalprofis", me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësi dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave", me nr. prokurimi: 6120/16/097/221, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Fushë Kosovë.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* **"Er-Lis sh.p.k & Ve-Mor" sh.p.k – Pejë**
N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* **"NTSH"Kanalprofis" - Fushë Kosovë**

Pikat e Ankesës: "Er-Lis sh.p.k & Ve-Mor" sh.p.k – Pejë:

- Neni 62 i LPP-së, paragrafi 2.1.2.2 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit).
- Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).
- Neni 7 i LPP-së, (Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim).
- Interpretimi i KRPP lidhur me gabimet e mundshme të TVSH-së Faqja zyrtare e KRPP -pytjet interesante - Nr 46.
- Neni 2 - Perkufizimet - LIGJI Nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar,

Pikat e Ankesës: NTSH"Kanalprofis" me seli në Fushë Kosovë:

- Neni 1.1,1.2 dhe 1.3 i LPP-së.
- Neni 6.1 dhe 6.2 i LPP-së.
- Neni 3.5 i LPP-së.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet: "Er-Lis sh.p.k & Ve-Mor" sh.p.k – Pejë:

Të nderuar, gjatë krahasimit dhe vlerësimit të tendereve keni bërë shkelje esenciale të LPP-se dhe ate:
- Neni 62 i LPP-së Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Anulimi i procedures se prokurimit,pas hapjes së Ofertave bie ndesh me parimet dhe dispozitat e LPP-së,

si dhe Legjislacionit dytësor i nxjerr nga KRPP.

Keni bere shkelje sepse sipas Nenit 62 paragrafi 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2. I të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, apo 2.2.para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Neni 59 te LPP-se Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe Neni 7 i LPP-se, Barazia në Trajtim / Jo Diskriminim

Gjatë vlerësimit së pari keni deklaruar se OE e propozuar për kontratë është i përgjegjeshem dhe e keni propozuar për kontratë, në spjegimin e Juaj keni thënë se OE eshtë i përgjegjëshëm me Çmim më të ulët kurse për konzorciumin ER-LIS & VE-MOR jeni shprehur që jemi të përgjegjëshëm por Çmimin e kemi të lartë.

Pas Kërkeses për Rishqyrtim OE-në e propozuar për kontratë e keni cilësuar si të papërgjegjëshme. Kurse konzorciumin ER-LIS & VE-MOR , së pari, komisioni Vleresues i Komunese na ka vizituar duke verifikuar të gjithë makinerin e nevojshme për realizimin e Kontrates(nuk eshte cekur fare në pergjigjen e AK) e pastaj me dat 10.02.2017 na ka informuar lidhur me Refuzimin e pjesërishëm të Kërkesës për Rishqyrtim , ku na ka shpallur të pa-përgjegjëshëm me sqarimet të cilat nuk janë pjesë që lidhet me ligjet e LPP-së por duke u mbështetur në Nenin 2 te Ligjit nr.05/L-037 per Tatimin mbi vleren e shtuar,

Neni 2 i Ligjit nr.05/L-037-Perkufizimet

Neni 2 ka 41 paragrafe nga:1.1 deri te paragrafi 1.41 , andaj nuk e kemi të qartë se cilin paragraftë ketijë LIGJI nuk e kemi Respektuar ? Sepse asnjeri paragraf nuk sqaron Normat e TVSH-së Po ashtu të Ju njoftoj se Tatimi mbi vleren e shtuar(TVSH) nuk është përfitim por DETYRIM ndaj ATKsë -Shtetit. andaj edhe nëse ka gabime lidhur me aplikimin e Normes se TVSH-se ne si kompani nuk kemi perfitime.

- Interpretimi i KRPP lidhur me gabimet e mundshme të TVSH-së sqron:

Faqja zyrtare e KRPP pytjet interesante Nr 46 thotë:

Pytje:

Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Pergjigje:

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

PROPOZIM: OSHP-së i propozojmë që me rastin e shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga OE ERLIS SHPK & VE MOR SHPK - PEJE lidhur me aktivitetin e prokurimit"Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,pastrimi i rrugëve,ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave" të nxjerr :

VENDIM:

- APROVOJË si të bazuar ankesën e" OE ER-LIS & VE-MOR" SHPK
- ANULOHET vendimi - per anulim e procedures se prokurimit,dhe lënda te kthehet në Ri-vlerësim.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet: NTSH"Kanalprofis" me seli në Fushë Kosovë:

Autoriteti kontraktues fillimisht ka ndjekur procedurat sipas LPP-së, pastaj është ndikuar nga OE "Er-lis"sh.p.k dhe "Ve-mor" sh.p.k, i cili ka rezultuar në anulimin e lendes, i cili ndikim ka bërë që AK-ja të bëjë shkelje esenciale të LPP-së.

Sqarim: AK-ja pas vlerësimit ka kërkuar s'qarime nga OE "Kanalprofis", për tri pozicione të paramases, se janë çmime të ulëta, ne kemi bërë s'qarimin edhe pse pozicionet me çmim të ulët kanë qenë një sasi mjaft e vogel që nuk ka fare ndikim financiar te kompania "Kanalprofis" dhe si garanci edhe më e madhe ne kemi garantuar sigurim bankar deri në 30% nëse ndihen jo të sigurt rreth ekzekutimit të kontratës. Autoriteti kontraktues e ka kuptuar se ne kemi qase serioze ndaj lendes në fjalë dhe ka vazhduar procedurat duke shpallur:

- Njoftimin për dhënien e kontratës
- Letrën standard për tenderuesin e suksesshëm.

Pas shpalljes së dokumentave të lartë cekur OE "Erlis&Ve-mor" sh.p.k, kanë kërkuar qasje në dokumentacionin tonë dhe pastaj AK-ja I është bindur OE "Erlis&Ve-mor" sh.p.k, për të anuluar të gjithë proceduren. Kjo situate na bënë të dyshojm se mundet të ketë nuance të manipulimit të situates në mes të Autoritetit kontraktues dhe OE "Erlis&Ve-mor" sh.p.k, duke shkelur nenin 3.5.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....28.12.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Shërbime/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 18.01.2017

Data e hapjes së ofertave (N.58):.....18.01.2017 -ora 14;30h
Data e njoftimit për anulimin e akt. prokurimit.....16.02.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	LOT	Çmimi	Vëretje
1	"ERLIS&VE-MOR" SH.P.K	PEJË	--	99,792.01€	JO
2	NTSH 'KANALPROFIS"	F.KOSOVË	--	79,957.75	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë dy (2) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Përstatshmëra e OE me kërkesat e nenit 65 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 – deklarata nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e Aneksi 2 në dosjen e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit.
b. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni m vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tender (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës .....origjinal ose kopje vërtetuar)

Një vërtetim nga autoriteti kompetent gjyqësor i vendit te themelusit të tenderuesit (GjTHK) se tenderuesi nuk ka pengesa lidhur me Kërkesat e pershtatshmerise Pika 6.2 .nën a,c,d,e,f dhe pika 6.3 nen a.b. dhe d. të dosjes se tenderit jo me te vjeter se 6 (gjashtë) muaj nga data e fundit te dorezimit te tenderit (duhet të dorëzohet nga tenderuesi që propozohet për dhënje të kontratës- kopje

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

a. Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe /apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
b. Çtifikata e numrit fiskal.
c. Çertifikata e regjistrimit për TVSH.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e juaj të themelimit me të cili evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend – kopja e çertifikatës së biznesit
b. Kopja e çertifikatës së numrit fiskal .

Kopja e çertifikates se regjistrimit për TVSH (deklarues).

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N/A

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional:

a. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku tri kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit (2013,2014,2015)
b. Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt.
c. Operatori Ekonomik duhet të emëroj menaxherin e projektit.
d. Operatori Ekonomik duhet të posedoj pajisjet teknike të nevojshme (autocistern për bartjen e ujit min.5m³, autocistern per zhbllokimin e kanalizimit i pajisur me pompa të presionit të lartë,kamion-kamere për inqizimin e rrjetit të kanalizimit,kamion special për transportin e mbeturinave 7m³ dhe 10m³.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar : produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve – kopje.
b. Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe fuqis tjetër punëtore (min. 5 punëtorë) – dëshmi lista e punëtorëve.
c. OE në kuadër të stafit duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jet inxhinjer i ndërtimtaris me së paku tri vite përvojë pune në profesion e dëshmuar me diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e punës ,të jet në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi .

Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë– pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësin e tyre , ose DUD-i doganor, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen- të dorëzohen në kopje të qartë dhe të lexueshme.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Adnan Bullatovci: Kryesues,
Bashkim Krasniqi: Anëtar,
Sylejman Shabani; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 10.02.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësimit të ofertave pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të pranuara konstatoi që të mos shpërblehet me kontrat asnjë prej operatorëve ekonomik pjesëmarrës, pasi që OE "KANALPROFIS" ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta, kurse OE "ER-LIS&VE-MOR" nuk ka respektuar normen e TVSH-së për ofrimin e shërbimeve publike, prandaj këto OE për çmime janë të papërgjegjshëm.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1):

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për shërbim, vlerë e mesme, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

I pakënaqur me njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 16.02.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues në konzercium: "ER-LIS"sh.p.k & "VE-MOR" sh.p.k, fillimisht ka parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 20.02.2017, me pretendim ankimor se nuk është respektuar:
Neni 7, i LPP-së, (Barazia në trajtim/Jo Diskriminimi),
Neni 59, i LPP-së, (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve),
Neni 62, i LPP-së, paragrafi 2.1 dhe 2.2, (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit)
Neni 2 i Ligjit Nr.05/L-037, për tatimin mbi vleren e shtuar,

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor nr.1
Në lidhje me pretendimin ankimor OE ankues "ER-LIS&VE-MOR"sh.p.k sa i përket arsyes të eliminimit në lidhje me normen e TVSH-së të ofruar për pozicionet e çmimit nr.13,14,15,16,18,19,20,21 dhe 22.

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor qëndron duke u bazuar në atë se Autoriteti kontraktues është i obliguar **korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.**
Citim: interpretimi i KRPP-së të publikuar në pyetje dhe përgjigjje nr.46, citojmë: "si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë.

Pretendimi ankimor nr.2

Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 59 të LPP-së, vlerëson se qëndron pasi që Autoriteti kontraktues gjate ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertvae NUK ka vepruar ne harmoni me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, duke eliminuar OE ankues në fjalë edhe pse I njejti kishte ofertuar në harmoni me kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Pretendimi ankimor të parashtruar nga ana e OE ankues NSHT "KANALPROFIS":
I pakënaqur me njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 16.02.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues: NSHT "KANALPROFIS", fillimisht ka parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 28.02.2017, me pretendim ankimor se nuk është respektuar:
Neni 1.1, 1.2 dhe 1.3:
Neni 6.1 dhe 6.2:
Neni 3.5,

Eksperti shqyrtues fillimisht s'qaron se OE ankues "Kanalprofis", nuk ka arritur të përshkruaj saktë rrethanat faktike apo dispozitat që pretendon që përbëjnë ose që ngrisin supozimin për shkeljen e këtij ligji, në harmoni me nenin 111, paragrafi 1.6 dhe 1.8 të LPP-së, i njëjti duke u bazuar në nenin e lartë cekur paragrafi 1.5 lidhur me nenin 4 të LPP-së NUK dëshmon interes material-juridik pasi që në asnjë rrethan NUK mundet të jetë nënshkrues i kontratës për këtë aktivitetit të prokurimit, duke u bazuar në atë se OE ankues ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta dhe i njëjti pranon në ankes dhe përgjigjje me shkrim drejtuar AK-së se ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta për pozicionet nr.3,6,7 dhe 8, që e bëjnë të papërgjegjshme oferten e këtij operatori ekonomik.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të bazuar, ankesën e OE ankues "ER-LIS&VE-MOR"sh.p.k, me seli në Pejë, ndërsa ankesen e OE ankues NSHT "KANALPROFIS" me seli në Fushë Kosovë të HUDHET POSHTË si e palejuar, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të kthehet në RI-VLERËSIM, këtë aktivitet të prokurimit: "Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, pastrimi i rrugëve, ujitja e hapësirave publike dhe transporti i mbeturinave , me nr. prokurimi:6120/16/097/221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Fushë Kosovë.